



ILIRICUM
SACRUM



Ai popull që nuk njeh të shkuarën e tij ngelet fëmije nga ment.

KUVEND NKOMBËTAR

**“VAZHDIMËSIA HISTORIKO-GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE E SHQIPTARËVE
PËRMES MIJËVJEÇARËVE,,
TIRANË, 09-11 MAJ, 2019, MUZEU KOMBËTAR**

Qarkullori i parë

Qëllimi: “Rritja e vetëdijes së shqiptarëve mbi rëndësinë e njohjes së lidhjeve të historisë së tyre me kulturat e antikitetit”

Ideja: “Në kërkim të historisë së prejardhjes dhe zhvillimit të gjuhës sonë përmes mijëvjeçarëve”

T’u kthejmë shqiptarëve, ç’u kanë marrë shqiptarëve

Organizatorët:

QENDRA KOMBËTARE "RRËNJËT TONA"

SHOQATA “ALEANCA QYTETARE PËR MBROJTJEN E VLERAVE KOMBËTARE”,

SHOQATA: “ILIRICUM SACRUM”

SHOQATA “IMAZHI SHQIPTAR”

SHOQATA “VLERAT SHQIPTARE”


QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE – G & G GROUP

Me mbështetje të: Të Presidentit të Republikës së Shqipërisë

Në bashkëpunim me:

Institucionet Universitare Shqiperi, Kosove, Maqedoni

Lajtmotivi: *Lavua e jep një eshtë të të jap një skëlet.*



Çdo popull ka të drejtë të kërkojë dhe njohë rrënjët e historisë së tij, si gur themelor për ekzistencën dhe ndërtimin e së ardhmes së tij!




PSE DUHET TË ORGANIZOJMË KUVENDIN “VAZHDIMËSIA HISTORIKO-GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE E SHQIPTARËVE PËRMES MIJËVJEÇARËVE,,

Qasja, sikundër sot, me një KUVEND Ndërkombëtar sillet në një kohë, ku vepra historike shqiptare vjen duke u zgjeruar, për pasojë, siç arsyeton filozofi Kroçe, çdo gjeneratë e ribën historinë e vet, ndaj edhe vetëdija historike na bën të arsyetojmë, pse jo, për një histori tjetër. Ka ardhur koha të mendojmë sesi historia e shqiptarëve të shkruhet me dashuri nga bijtë e vet, sepse mosdija e historisë sonë, harresa në të cilën gjendemi për gjyshërit e stërgjyshërit tanë, mos kujdesia ndaj armikut dhe mikut kombëtar, gjithë këto, na kanë bërë që të mos njohim veten tonë dhe të na duken të mira disa të meta, po edhe të harrojmë virtytet tona.



Thot-Hermes-Merkuri me qeleshe, i cili mban në dorë simbolin e besimit Pellazg Hëna/Yli. Këtë simbol e shikojmë edhe tek stema e mbretërise së Arbërve dhe në qeleshen e Aleksandrit të Madh. Është i pajisur me krahë shqiponje që tregon se i përket një periudhe shumë të lashtë.

1. Ngjarje të tilla si ky KUVEND duhet të na bëjnë që të mësojmë të vërteta për shqipërinë dhe shqiptarët, për të cilat ka nevojë çdokush, por ne shqiptarët kemi nevojë më tepër se gjithkush, që siç thotë akademiku kosovar Feti Mehdiu: “E vërteta është ilaç i hidhur, por shërues, me kushtin që ilaçi të përdoret me kohë”.
2. Një KUVEND i tillë duhet të na tregojë sesi manipulimi nuk duhet të rrisë shanset që sharlatanët të jenë të pëlqyeshëm për turmat, ndërsa miqtë e vërtetë të popullit të dështojnë. Prandaj, Shqipëria ka nevojë për qytetarë e patriotë që nuk bien viktimë e manipulimit të pasioneve mbi historinë, qoftë nga ata jashtë ose ndonjë syresh brenda. Një KUVEND i tillë duhet të na bëjë që individit dhe populli të ndjehen të pjekur, se ndryshe po vemi drejt një prirje të dëmshme për demokracinë. Sigurisht, nuk do të merren armët, por një shpirt kritik duhet t’i qaset interpretimeve të ngjarjeve historike dhe historisë së gjuhës shqipe.
3. Një KUVEND i tillë duhet të na sjellë filozofi që ka nevojë historiani, gjuhëtari, arkeologu, studenti në mësim e bujku në arë, por për atë filozofi, siç shprehet Niçe-ja “perëndeshë të ndershme dhe lakuriqe”. Boll më me historinë e shpikur helene e latine. Po këta ilirë, thrakë e pellazgë që jetuan midis tyre, ç’ishin? Si mbijetuan, si komb e si gjuhë, kur këta të fortët dolën nga faqja e historisë. Pse ishin komb e gjuhë e ‘dobët’ apo pse ishin më të vjetër e më të rrahur me historinë?



SKEMË E PEMËS SË GJUHËVE

*E ndërtuar prej Institutit të gjuhësisë,
Stokholm 1974*

Formimi dhe shpërndarja e popujve me bazë popullore parakë (pëllëzë, paratit, prototitë) qëvë pas rryfës së globale (8000 vjet para Eëfëtit), por me ndëvësimin në nuk uëin popujt indoevëropan, por tipëq mjerëz i shëvëtar nëa këndëvëta e fundit dhe të pas jetës në shëvëta, pëkëvërit ata të në trunq i dardasë, dë, tërakë, epërit, hitit, frëgjanë tëshëvëta të mëvëvëtimel, për kërrëvë indoevëropanë. Cë popujt induevë në këto trevë?

Të ngëkëvëshëm në të këy trunq induev, normalisht që po.

S.GURI



(Mirënjohje Xhennaf Gashi)

Shqiponja me dy këna e gjetur në trevat ku banonte populli Hittit.

5. Një KUVEND i tillë duhet të na sjell fakte e interpretime, sesi mund të na ndihmojë historia për të organizuar lirinë dhe të bëhemi



7. Një KUVEND i tillë duhet të na japi mundësinë që të mos e trajtojmë historinë, si një koleksion të thjeshtë antikitetesh, sikundër thotë filozofi i shquar gjerman Haideger, por para së gjithash ne duhet të kuptojmë se historia nuk qëndron pas nesh si një objekt. Përkundrazi, ne jemi vetë historia. Për pasojë, jemi ne përgjegjës për mënyrën sesi e trajtojmë atë. Ndaj, pesha e fajit është aq, sa dëmi i bëhet atdheut.
8. Një KUVEND i tillë duhet të na bëjë që të shikojmë dy hapa para, por edhe një hap prapa, ndryshe nga mendësia e sotme politike botërore që iu kërkon popujve të mos merren shumë me histori dhe të mos shikojnë nga e kaluara. Nëse njeriu, thjesht shikon, ka veçse logjikën e kafshës.
9. Një KUVEND i tillë duhet të bëjë qytetarin dhe shtetarin shqiptar që duhet të dijë kush jemi, për të qenë të barabartë me të tjerët. Ndaj është koha që ne vetë të shkruajmë historinë tonë, duke mos qenë, as të verbër e as sqimatarë, dhe historia jonë nuk mund të shkruhet nga okupatorët e shërbëtorët me mel'hem e pa bereqet, sepse historia na ka mësuar deri më sot, siç na thotë i madhi filozof Hegeli, atë që nuk para mësojmë shumë nga historia. Ndaj shqiptarët do të vuajnë dhe syresh të tjerë do të përfitojnë, kjo e lidhur edhe me servilizmin e pashoq të bashkë atdhetarëve tanë, kinse gjoja pragmatistë.



Mbretresha e parë grua në perandoritë antike (Helene, Romake, Egjiptiane dhe Ilire)




10. Një KUVEND i tillë duhet të na bëjë të mbajmë qëndrim ndaj këtij realiteti që më të trishtë e më zezan e kanë bërë vetë shqiptarët, ca nga padija e mungesa e vizionit, ca nga ofertat e vjetra e të reja në lëmin e konspiracionit. Sikur nuk mjaftojnë paudhësitë e shteteve fqinj dhe atyre perandorakë ndaj shqipërisë dhe shqiptarit, ndaj historisë dhe gjuhësisë sonë, por na duhet të jemi dhe servil ndaj tyre, aq sa shumë syresh prej nesh i quajnë pushtimet bashkëpunime.

11. Një KUVEND i tillë dhe nisma të tilla duhet të na sjellin

të verteta historike, për të qenë të vërtetë me faktet, sepse nga historia e shkruajtur për shqipërinë dhe shqipëtarët ka thënie të tmershme, sidomos kur i dëgjon nga goja e personave kyç të vendit, me po aq urrejtje sa akademikët serb e maqedonas.

12. Një KUVEND i tillë nuk vjen për të treguar, secili patriotizmin e vet, se sot njerëzit e kulturuar në çfarëdolloj profesioni, më tepër i përkasin qytetarisë së botës, sesa vendit pikë oqean ku jetojnë, por për të treguar se historia ka lindur si mjet për të kryer një **funksion hyjnor**, ne edukimin e brezave të rinj,





ne orjentimin e politikberesve sipas traditës, e cila e ka bazen e formimit ne Dijen Hyjnore. Ndaj, na duhet të flasim, me motivin, sesi të mos vuajmë nga mungesa e personalitetit, aq më tepër ne shqiptarët.

13. Një Kuvend i tillë na ndihmon që të bëhemi të vetëdijshëm për rëndësinë e njohjes së historisë së prejardhjes sonë, për të kuptuar peshën e kësaj vlere historike në shkallë kombëtar dhe ndërkombëtar, për të marrë përsipër me dinjitet përgjegjësinë e kësaj peshe si trashëguesit dhe mbartësit themelor dhe të drejtpërdrejtë të këtyre vlerave historike dhe gjuhësore.



14. Një Kuvend i tillë na ndihmon që të kuptojmë realitetin e trishtë që po jetojmë sot, për të zgjedhur me zgjuarsi rrugë të reja për kapërcimin e tij.

15. Ky Kuvend do të na ndihmojë që të drejtojmë vëmendjen tek fryma e Shkollës Arbëreshe mbi Albanologjinë, e cila më tepër se një Institucion Arsimor, ishte veprimtaria e një elite të bashkuar, që bëri si qëllim të saj, ruajtjen e gjuhës dhe historisë kombëtare, për ruajtjen e prejardhjes dhe etnisë.

16. Një Kuvend i këtij formati na afron mundësinë që nëpërmjet fakteve të hidhet dritë mbi atë pjesë të hershme të historisë sonë, e cila deri tani është lënë në harresë

17. Duke njohur historinë tonë të hershme ne do të dimë të bëhemi të vetëdijshëm për rolin tonë në kohët e reja.

Gjithë këto e të tjera na bëjnë ta shohim historinë sy më sy, sepse ta rishkruash historinë nuk do të thotë aspak ta qortosh atë.

QËLLIMI I KUVENDIT

1. Mbajtja e këtij kuvendi ka si qëllim që të parashtrojmë fakte historike, gjuhësore dhe etnokulturore të hulumtuara nga studiues të ndryshëm, të cilat vërtetojnë lidhjen e shqipes së sotme me gjuhët e antikitetit, dhe nëpërmjet tyre vazhdimësinë e pandërprerë të historisë sonë.
2. Mbajtja e këtij kuvendi ka si qëllim që të ndricojë atë pjesë të historisë sonë më të hershme, e cila deri tani është lënë në harresë.
3. Një KUVEND i tillë vjen për të ndihmuar në krijimin e një ndërdije tjetër, sepse 'ndërdija deri më sot për





shqipërinë dhe shqiptarët është tmerruese'. Dhe meqënëse, kjo ndërdije, njeriut i është futur në ndërlidhje si ndodhi apo si e thënë, pavarësisht, a qëndron apo nuk qëndron, është krijuar bindja se ajo është e vërteta".

4. Ky KUVEND duhet t'i tregoj shqiptarëve, përse janë në mesin e Europës dhe jo european, ku piketa të pakontestueshme vertetojnë ne emra toponimesh praninë e tyre qysh në antiktet dhe para saj?



5. Kësisoj, një KUVEND i tillë, nuk do të përbëjë aspak një apologji për shqiptarët, por një KUVEND, ku mund t'iu japim atyre të drejtën. Sepse, ata vetë kanë neglizhuar shumë për publicitetin dhe kanë bërë gabim - thotë e fortndritura Elena Gjika (Dora d'Istria) që shqiptarët, kanë jetuar shumë pak për veten e tyre. Veprimtarinë e tyre, gjakun e tyre, talentin e tyre e kanë përfituar fqinjët.

Ndaj, ata (shqiptarët) duhet të fillojnë një epokë të re sot, të jetojnë dhe të punojnë për veten e tyre, për shqipen e tyre.

OBJETIVAT E KUVENDIT

1. Me patjetër na duhet të vazhdojmë të njohim dhe të shkruajmë të shkuarën.
2. Pse nevojitet? Pse është e domosdoshme? Çfarë duhet kërkuar në të? Si duhet shkruar? E shkuara nuk kthehet dhe nuk ndryshohet më?!
3. Porse, filli i muzave të saj ndihmon të krahasohet e shkuara me të tashmen që dmth se e shkuara është e detyrueshme të shkruhet, si ka qenë dhe si ka ndodhur, e vërtetë faktike e përlidhur, jo si dëshirë vetiake e tanishme sesi duhej të kishte qenë.



4. Na duhet të njohim njerëzit dhe ngjarjet e shkuara për t'i analizuar dhe matur me peshoren e çështjes shqiptare, se çfarë prodhuan njerëzit si individë apo grupe shoqërore me sjelljen dhe mentalitetin e tyre të at'hershëm, si notuan ato në rrymat e kohës, si rrodhën ngjarjet dhe njerëzit, nga ku dhe drejt ku?!



5. Çfarë i mungoi ose e pengoi Perandorinë pellazge të Egjeut, apo atë Ilire të Adriatikut, apo atë Thrake të brenda kontinentit deri në atë shqiptare të Mesdheut 'Albanica Imperium' të dallohej ndër shekuj si e tillë?
6. Çfarë ishte ndryshe më parë? Çfarë është e njëjtë tani? Çfarë mungoi dje? Po sot? Çfarë nuk është vënë re dje? Po sot?

Dhe së fundi fare, për të sjellë fjalët epike për këtë popull të gruas së këndshme Elena Gjika, e cila nga shpirti i saj zbrazti mendime e fjalë të mbushura me mallëngjim se: Çfarë kërkimesh duhet të bëj për të ndjekur këtë racë (shqiptarët) që merr përsipër përgjegjësi në Stamboll, në Hidra, kudo, etj? Ky popull vepron shumë, por nuk shkruan aspak.



Pamje e një vajze shkodrane e vitit 1943, me tipare tipike të shqiptare, ku zot se gjën kaq harmonishëm treguesit e kafkës, e fytyrës deri në linjat plot hire të trupit.

PËRFUNDIMI

1. Nga sinteza që iu bëjmë mijëra librave të lexuar kuptojmë atë që akademikët tanë nuk na i paskeshin thënë se "Historitë shqiptare, përpos gjuhës shqipe, janë një tjetër pohim se kultura shqiptare është aq e përbotshme, saqë sapo zbulohet një dritare, një tjetër del pas saj, dhe lumë ai që di t'i hapi të gjitha.
2. Se ç'të shoh?! Vëren sesi pas hapjes së tyre të shtrihet përpara një hapësirë shumë e madhe tokësore, detare, njerëzore, kulturore, e vetëdijshme dhe e pavetëdijshme, e botuar dhe e skalitur me forma të ndryshme, e tretur ose e lënë në harresë, e dukur ose e padalluar.
3. Gjithsesi, sipas mendimit tonë, nisur nga ç'na detyron e kaluara jonë është se kjo racë e ashpër dhe tolerante njëkohësisht, e zgjuar, shumë punëtore, thellësisht e ndershme, është e paracaktuar për një të ardhme të shkëlqyer.

E ardhmja do të tregojë se cilat ishin qëllimet e Zotit, i cili bëri të lumtur ruajtjen e kësaj race kaq të lartë.

TEMATIKAT E KUVENDIT

KUVENDI synon në:

1. mbledhjen, zhvillimin dhe përhapjen e informacionit në shkallë kombëtare e ndërkombëtare në të gjitha aspektet e kërkimit dhe zbulimit të të dhënave mbi vlerat e gjuhësisë dhe historisë së popujve të vjetër e parak të



*(Mirënjohje Shoqatës Forumi Shqiptar).
Pamje e kopertinës së librit të parë shqip me autor Teodor Shkodran, të zbuluar deri më tani në Arkivat e Vatikanit, çka vërteton thënien e klerikut të Tivarit në letër drejtuar Papait të kohës më 1332.*

S.GURI



- Europës dhe Shqipërisë;
2. promovimin dhe diskutimin mbi çështjet strategjike lidhur me to;
 3. ofrimin dhe organizimin e edukimit në menaxhimin e koncepteve për këto vlera.



TEMAT E KUVENDIT

Tema e përgjithshme e KUVENDIT do të jetë “Trashëgimia kulturore jo materiale shpirtërore që nënkupton praktikën, paraqitjet, shprehjet, gjuhën, njohuritë dhe krijimtarinë popullore, si dhe veglat, objektet, artizanatin dhe hapësirat kulturore që bashkëshoqërojnë ato, e krijuar në shekuj e në vijimësi dhe e përcjellë brez pas brezi, duke i dhënë kombit shqiptar ndjenjën e identitetit dhe të vazhdimësisë, duke ndihmuar kështu për promovimin e respektit për diversitetin kulturor dhe të krijimtarisë tradicionale njerëzore.”

Tematikat e veçanta të KUVENDIT do të jenë:

I. HISTORIOGRAFIA

- I.1 NJERIU PARAHISTORIK
- I.2 POPUJT DHE Fiset kryesore që ndërtuan PELLAZGJINË
- I.3 POPUJT E TRUNGUT PELLAZGO - ILIRO- THRAKË
- I.4 KUSH JEMI NE SHQIPTARËT?
- I.5 KUSH JEMI NE ALBANËT DHE/OSE ARBANËT?
- I.6 KUSH ISHIN ILIRËT?
- I.7 KUSH ISHIN PELLAZGËT?
- I.8 TË VEÇANTAT DHE TË PËRGJITHSHMET NË TIPOLOGJINË E SHQIPTARIT
- I.9 SHQIPTARËT, KOMB QYSH PREJ PELLAZGËVE APO BASHKËSI ETNIKE
- I.10 SHTRIRJA GJEOGRAFIKE NË HAPËSIRË E KOHË E PELLAZGËVE



II. GJUHËSI



II.1 GJUHA SHQIPE NË MIJËVJEÇARË

II.2 GJUHA PARAKE NË KËNDVËSHTRIMIN E
STUDIUESVE TË HUAJ

II.3 MARRËDHËNIET MES PROTOSHQIPES
DHE

GJUHËS LATINE;

II.4 MARRËDHËNIET MES PROTOSHQIPES
DHE

GJUHËS HELENE;

II.5 MARRËDHËNIET MES PROTOSHQIPES
DHE

GJUHËVE PARA ANTIKE

(HEBRAISHTË,

BABILONASE, SUMERE, EGJIPTIANË);



II.6 LETËRSIA POPULLORE/LEGJENDAT, PËRRALLAT, GOJËDHËNAT, KËNGËT,
NINULLAT, GJËEGJËZAT.

III. ETNOKULTURË

III.1 KANUNET DHE E DREJTA E VJETËR DOKËSORE

III.2 MITOLOGJIA DHE DEMONOLOGJIA SHQIPTARE

III.3 PAGANIZMI-FESTAT, KREMTIMET DHE KALENDARËT PELLAZGO-ILIRE

III.4 KOSTUMET DHE VESHJET

III.5 DASMAT DHE MORTI, ZAKONET E
POPUJVE THRAKO- ILIRE DHE PELLAZGO-
EPIRE


III.6 FOLKLORI GOJOR I RUAJTUR NË
KUJTESË, I SHKRUAR OSE I REGJISTRUAR,
KOREOGRAFIK DHE INSTRUMENTAL

III.7 ZAKONE DHE DOKE TRADICIONALE

III.8 BESIME DHE BESËTYTNI TË TRADITËS,
DOKET DHE RITET, BESIMET POPULLORE

III.9 ZEJET E NDRYSHME TRADICIONALE

III.10 MUZIKA, KËNGËT DHE VALLET






POPULLORE.

SESIONET E KUVENDIT

Kuvendi do të zgjasë së paku 2 (dy) ditë dhe do të përfshijë mënyrat e mëposhtme të prezantimit:

1. Pezantim me gojë;
2. Prezantim me anë të posterave;
3. Promovim libri;
4. Panair libri;
5. Ekspozitë.



PJESËMARRËS

1. Studiues nga vendbanimet shqiptare në Mal të Zi, Serbi, Maqedoni, Kroaci.
2. Akademikë dhe Albanologë nga Kroacia, Bosnja, Japonia, Shën Petërburg, Palestina, Jeruzalemi, Rumania, Bullgaria, Gjermania, Varshava, Francë, Sardenjë, Kreta, Vatra në ShBA, Itali.
3. Pedagogë e njohës të gjuhës shqipe të arbëreshët e Italisë, të arvanitasit e Greqisë e kudo.


TË FTUAR

Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministrat e Arsimit dhe të Kulturës të kryeqyteteve të Ballkanit, Akademitë, Athinë, Beograd, Shkup, Prishtinë, Mali i Zi.

THIRRJA E PËRMBLEDHJEVE

Një përmbledhje (abstrakt) i zgjatur (së paku, gjysëm faqe, por jo më shumë se një faqe e plotë) duhet t'i dërgohet Komitetit Shkencor, jo më vonë se data 28 Shkurt 2019. Në përmbledhje duhet të kihet parasysh që:

1. Përmbajtja e punimit (raste studimi të detajuara, të dhëna e artefakte të mbledhura, studime e referate apo artikuj të plotë, të cilët nuk janë prezantuar më parë në Shqipëri)
2. Autori kryesor, që duhet të përcaktohet qartë.
3. Çdo autor kryesor mund të parashtrojë, jo më shumë se dy përmbledhje;
4. Një format abstrakti duhet të shkarkohet nga faqja e internetit të KUVENDIT.
5. Gjuha zyrtare e KUVENDIT do të jetë shqipja dhe anglishtja, e cila do të përkthehet në mënyrë të njëkohshme për secilin nga pjesëmarrësit.





6. Të gjitha dokumentet duhet të shkruhen dhe të paraqiten në gjuhën shqipe dhe angleze, në Times New Roman, font 12, me hapësirë 1.3, me foto, skema ose shifra përkatëse që duhet të punohen në Corel për efekte editimi. Autorët pritët të marrin pjesë në KUVEND dhe të prezantojnë punimet e tyre.
7. Artikujt e pranuar do t'i komunikohen autorëve deri në 15 Mars 2019 për abstraktet dhe 10 Prill 2019 për punimet shkencore. Nëse njoftimi nuk është marrë deri në fund të këtij muaji, autorët duhet t'i drejtohen Organizatorëve.
8. Punimi i plotë (maksimumi 10-12 faqe) duhet t'i dërgohet Organizatorëve, jo më vonë se data 31 Mars 2019, i cili duhet të jetë në përputhje me rregullat e një artikulli shkencor, pra i gatshëm dhe direkt për botim. Artikulli i plotë duhet të përmbajë përmbledhjen prej jo më shumë se 10 rreshta, fjalë kyçe, jo më shumë se 7-10 te tilla, hyrje, zhvillim sipas dy apo tre çështjeve, përfundime, dhe studime apo referenca mbështetëse të shpërndara në tekst dhe në fund të artikullit. Dhe më kryesorja, (se ndryshe artikujt nuk do të pranohen), do të jenë me drejtshkrimin më të mirë të mundshëm të shqipes zyrtare.
9. Pjesëmarrësit do t'iu krijohet mundësia e shkarkimit të materialit të plotë të studiuesit që janë të interesuar.
10. Punimet do të vlerësohen nga Komiteti Shkencor.
11. Do të ketë libër përmbledhjesh shqip-anglisht
12. Do të ketë libër përmbledhjesh të KUVENDIT, me artikujt e mbajtur në KUVEND.
13. Prezantimi do të bëhet në Power Point, duke respektuar kohën prej 20-22 minuta përfshirë pyetje e përgjigje.



Të gjithë artikujt e pranuar për t'u prezantuar në KUVEND do të publikohen sipas procedurave në dispozicion në fillim të KUVENDIT.

TARIFAT E PJESËMARRJES PËR RELATORËT

Anëtar i shoqatave me fokus studime mbi Historinë	10 €
Jo-antarë	20 €
Institucionet shtetërore / Qeveria	50 €
Stafi i Universitetit	30 €
Publiku	0 €
Studentë të tjerë	1 €



Student i universiteteve partnerë

0 €

THIRRJE PËR KUVENDISTËT/STENDAT E EKSPOZIMIT

- Do të ftohen për pjesëmarrje Komunitetet fetare.
- Fotoekspozitë me pamje Pellazgjike nga libra të botuar.
- Ekspozitë e librave të pjesëmarrësve në Kuvend, ku një ekspozitë jo e vogël do të mbahet së bashku me Konferencën, ku individë, organizata dhe institucione mund të shfaqin në formën e maketeve artefakte, figura me materiale shoqëruese.
- Do të ftohen pjesëmarrësit të dhurojnë nga 5 kopje për çdo libër me temë Pellazgjike;
- Do të kërkojmë sektor për studime mbi Pellazgjinë në mjediset e Akademisë së Shkencave;
- Stendat e ekspozimit do të jenë të disponueshme sipas tipologjive të mëposhtme, në mënyrë që kompanitë ekspozuese të zgjedhin atë më të përshtatshmen sipas nevojave të tyre të marketimit dhe sektorit që ata përfaqësojnë.
- Për informacion të mëtejshëm ju lutemi kontaktoni sekretariatin organizativ.




PROFILI I VIZITORËVE

Profili i vizitorëve: Përfaqësues të institucioneve arsimore dhe edukative, përfaqësues të institucioneve zyrtare dhe qeveritare, përfaqësues të bashkive dhe të administratave lokale, shoqata kulturore, Mediat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mese, qytetarë që dëshirojnë të njehin historinë e kombit, të cilit i përkasin.

VENDNDODHJA

- KUVENDI “VAZHDIMËSIA HISTORIKO-GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE E SHQIPTARËVE”, Tiranë më 09 Maj, 2019 do të mbahet në Muzeun Kombëtar, në Bulevardin kryesor, në qendrën kryesore të Kryeqytetit.
- Konferenca do të mbahet në sallën kryesore të saj me kapacitet prej më shumë se 300 vende, duke përfshirë shërbimet profesionale të përkthimit; sistem regjistrimi audio dhe





video.

- **Ceremonia e Hapjes:** në Pallatin e Brigadave (Pallati Mbretëror) më dt. 08 Maj, 2019, si dhe me prani të të ftuarve nga Trupi Diplomatik; Autoritetet Shtetërore; Specialistët në fushën e Historisë dhe Kulturës, etj.

UDHËTIMI DHE VENDQËNDRIMI


- Udhëtimi dhe vendqëndrimi: Delegatët, referuesit autorët e shkrimeve dhe pjesëmarrësit në Kuvend, do të kujdesen vetë për udhëtimin dhe vendqëndrimin. Në faqen zyrtare të kuvendit do të gjeni të afishuara informacione të hollësishme mbi zhvillimin e Kuvendit, oraret, referuesit, temat, si dhe sygjerrime mbi udhëtimin dhe mundësitë e vendqëndrimit. Delegatëve dhe pjesëmarrësve të Kuvendit do tju dërgohet një formular për tu plotësuar, me anën e të cilit bëhet aplikimi për pjesëmarrjen në Kuvend.

HAPJA E KUVENDIT

Kuvendi do të hapet në datën 8 Maj 2019 ora 19:00 në Pallatin Mbretëror, ku do të shfaqet një film mbi Shqipërinë. Të dhëna të tjera të hollësishme mbi këtë program do ti gjeni në faqen e tij zyrtare.

PROGRAMI SOCIAL

- Hapja e Konferencës do të mbahet në mbrëmjen e 08 Maj, 2019 në Pallatin Mbretëror (Pallati i Brigadave), ku do të shfaqet një dokumentar mbi Shqipërinë.
- Detajet e mëtejshme të ngjarjeve dhe programeve sociale për pjesëmarrësit, do të përfshihen në programin përfundimtar.



TURET E DELEGATËVE

Turet e delegatëve do të zhvillohen në qendrat historike e kulturore si Tiranë, Krujë e Durrës.

KËRKESAT E MËTEJSHME

- Një broshurë që paraqet një program të përkohshëm dhe përfshin formularin e aplikimit/pranimit, do t'u dërgohet të gjithë atyre që paraqesin një kërkesë.



- Formularët e aplikimit duhet të përmbajnë kushtet dhe tarifat e pjesëmarrjes.
- Për pyetje të mëtejshme dhe informacion ose regjistrim, ekspozitë, akomodim, etj., ju lutemi kontaktoni sekretariatit organizativ.

KOMITETI ORGANIZATIV

Stefan PINGULI	PRESIDENT I KUVENDIT, SHOQ. ILIRIUM SANCRUM
Hasan ALIAJ	REVISTA RRËNJËT
Astrit MEMIA	GJUHËLETËRSI
Lirim MUHAJ	GJUHËTAR, QENDRA KOMB.“RRËNJËT TONA”
Albert XHOLI	SHKRIMTAR
Besir BAJRAMI	PUBLICIST
Gazment TOSKA	BIZNESMEN, FRANCEZ, INXHINIER
Migena ARLLATI	GJUHËTARE
Aulon KALAJA	ALEANCA PËR MBRUJTJEN E VLERAVE KOMBTARE

KOMITETI SHKENCOR

Arif MATEW	HISTORIAN
Eleni KOCAQI	HISTORIANE, UNIVERSITETI I DURRËSIT
Eva BRINJA	QKRRT
Lutfi ALIAJ	STUDIUS HISTORIAN
Shpresa MUSAJ	GJUHËTARE/HISTORIANE
Xhemaledin SALIHU	SHOQ. TRASHËGIMI KULTUR. PRESHEVË
Niko STILLOS	ARKITEKT, (STUDIUS GJUHËTAR)
Saimir LOLJA	PUBLICIST/KANADA
Albert GJOKA	STUDIUS PËRKTHYES
Anastas SHUKE	SHOQATA PËR STUDIME PELLAZGE, TIRANË
Eleni SHPRESA	SHKOLLA ALBANOLOGJIKE E ARBËRESHËVE
Linda SPAHIU	MJEKE, STUDIUSE ETNOGRAFE
Mark PALNIKAJ	INXHINIER/STUDIUS HISTORIAN
Ardit ZENELI	ALEANCA PËR MBRUJTJEN E VLERAVE KOMBTARE

SEKRETARIATI I KUVENDIT

Sazan GURI	QENDRA KOMBËTARE “RRËNJËT TONA”
------------	---------------------------------



Arjola BAJRAMAJ

ANËTARE

INFORMACIONE PËR ORGANIZATORËT E KUVENDIT

1. Shoqata **QENDRA KOMBËTARE "RRËNJËT TONA"** ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi, konkretisht ligji nr. 8788, date 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurese". Është themeluar me vullnet të lirë nga një grup anetarësh nismëtarë dhe është një organizatë, jofitimprurëse. Ajo është një organizim jo qeveritar, i pavarur nga partitë e organizatat politike dhe gëzon liri dhe autonomi të veprimit në përputhje me Statutin, Programin dhe Rregulloren e saj. Veprimtaria e saj shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Anëtarët e parë themelues të Organizatës janë të gjithë ata individë, të cilët kanë nënshkruar deklaratën e themelimit dhe betimin për mbrojtjen e vlerave kombëtare.



Kala në Mal të Zi (maësi ilire)

Kalaja e Beratit pas 7000 vjetësh

Kala neolitike 7000 vjet para

*Vendbanime të kohës neolitike të popujve parak
(krahaso me vazhdimësitë e sotme në kalatë
shqiptare, Berat, Ulqin, Parga, etj.*

- Qëllimi i veprimtarisë së Organizatës është të ndikojë në politikat strategjike të shtetit Shqiptar që garantojnë mbrojtjen e vlerave kombëtare dhe në këtë kuadër saj të zhvillojë fushata periodike sensibilizuese për mbarë komunitetin shqiptar.
2. Shoqata **"ILIRIKUM SANCRUM"** ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi, konkretisht ligji nr. 8788, date 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurese". Është themeluar me vullnet të lirë nga një grup anetarësh nismëtarë dhe është një organizatë, jofitimprurëse.
 3. **"ALEANCA QYTETARE E MBROJTJES SË VLERAVE KOMBËTARE**, shkurt AQMVK" ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi konkretisht ligji nr. 8788, date 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurese", ligji nr. 8789, dt.07.05.2001. Aleanca Qytetare e Mbrojtjes së Vlerave Kombëtare është themeluar me vullnet të lirë nga një grup anetarësh nismëtarë dhe është një organizatë, jofitimprurëse. Ajo është një organizim jo qeveritar, i pavarur nga partitë e organizatat politike dhe gëzon liri dhe autonomi të veprimit në përputhje me Statutin, Programin dhe Rregulloren e saj. Organizata ka vulën dhe stemën e saj. Veprimtaria e saj shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Anëtarët e parë themelues të



Organizatës janë të gjithë ata individë, të cilët kanë nënshkruar deklaratën e themelimit dhe betimin për mbrojtjen e vlerave kombëtare. Qëllimi i veprimtarisë së Organizatës është të ndikojë në politikat strategjike të shtetit Shqiptar që garantojnë mbrojtjen e vlerave kombëtare dhe në këtë kuadër saj të zhvillojë fushata periodike sensibilizuese për mbarë komunitetin shqiptar.

4. **QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE G & G GROUP**

QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE - G & G Group ofron një kuadër të plotë të shërbimeve që mbulon fushën e Legjislacioniut, Mjedisit, Gjeoshkencës dhe Histori-gjuhësissë e etnokulturës.. Përgjegjësia për të menaxhuar sfidat e sotme dhe mbrojtjen e vlerave të kombit, kërkon zbatimin e njohurive të sotme shkencore.

5. **FORUMI" IMAZH & MEDIA**

Forumi Mbarëkombëtar "Imazhi Shqiptar & Identiteti Kombëtar" nën slloganin "Kombi Shqiptar, Imazhi Im" Forumi ka 23 vite që është themeluar, dhe Festivali Ndërkombëtar, "Imazhi Shqiptar", mbylli me sukses edicioni e 16(gjashtëmbëdhjetë), më 22 Dhjetor, 2018. Misioni i Imazhit Shqiptar për identifikimin dhe promovimin e vlerave të Imazhit Shqiptar nuk ndalet. Si çdo vit, Forumi "Imazh & Media", ka pritur në Kryeqytetin Shqiptar, në Tiranë, edicionin e Festivalit Ndërkombëtar "Imazhit Shqiptar", së bashku me miqtë dhe mbështetësit e kontributorët nga të gjitha trevat shqipfolëse. Tashmë, një traditë e veprimtarive të Forumit "Imazh & Media". Prezantimi i vlerave unike të Imazhit Shqiptar dhe Identitetit Kombëtar është bërë gjatë gjithë vitit me takime, seminare promovime librash e vlerash në të gjitha trevat mbarëshqiptare, që nga Gjakova ,Prizreni ,Prishtina duke u ndalur në Ulqin, Preshevë Shkup, e sigurisht në diasporën e largët si Romë, Bruksel, Gjenevë Stamboll e New York. Forumi "Imazh & Media" është një forum, që ka për qëllim integrimin e vendit në strukturat euroatlantike, organizma të tjerë rajonale si dhe në Bashkimin Evropian. Forumi, i përkushtohet interesit të Kombit Shqiptar, profilizimit dhe profesionalizmit të personave fizikë, juridikë dhe të individëve në përputhje me kërkesat e kohës.

6. **ORGANIZATA "ALVA " - ALBANIAN VALUES – VLERAT SHQIPTARE**

Organizata "ALVA - Albanian Values – Vlerat Shqiptare", është një organizatë jo fitim prurëse dhe jopolitike, e themeluar si një nismë e një grupi dashamirësish, artistë, historianë, aktivistë të njohur të shoqërisë civile, të apasionuar ndaj vlerave, kulturës, traditës, natyrës, gjuhës, letërsisë, folklorit të kombit shqiptar etj. "ALVA" zotëron karakter kulturor, informues, edukativ, shkencor që bazohet në evidentimin dhe promovimin e vlerave mbarëkombëtare kulturore, historike, njerëzore të vyera të kombit shqiptar, për të mundësuar ruajtjen dhe zhvillimin e tyre si dhe për të aspiruar integrimin e Shqipërisë në gjirin e Bashkimit Evropian, duke u identifikuar me historinë, kulturën, gjuhën dhe traditat e një kombi të barabartë në mes të barabartëve.



PROPOZIME QË MUND TË DALIN NGA KARTA E BARDHË E KUVENDIT - REZOLUTA

1. Të planifikohet studimi i pellazgjistes në të gjitha hallkat e arsimit shqiptar.
2. Të hidhen themelet e bibliotekës dhe bibliografisë me bazë dhurimin e veprave.
3. Të ngrëmë bërthama shkencore me studiues, kudo ku ka shkëndija të tilla.
4. Të gjejmë sponsor për veprën e pabotuar të Ç. Xhungës.
5. T'i propozohet Presidentit dekorimi i figurave si Spiro Kondo, Majani, Matew A., D. A'nzheli, P.Zheji, Jamomoto, Eleni Shpresa.
6. Të programohet në kurrikulumet në të gjitha ciklet e shkollës dhe në Fakultetin e Gjuhësise historiku, alfabeti dhe gjuha e Pellazgëve.
7. Të fillojë përgatitja e kuadrit në Fakultetet e Gjuhësisë për studimin dhe zbatimin në ciklet e shkollës shqiptare jeta dhe gjuha e Pellazgëve.
8. Kryesia e zgjedhur do të vërë në veprim formën pellazgjike të drejtimit me prostat (me rotacion).





KUJTESË!

*Hapí i parë në likuidimin e një populli është
të fshish kujtesën e tij historike.*

*Shkatërroni librat e tij, kulturën e tij,
historinë e tij.*

*Atëherë vini dikkë të shkruajë libra të rinj, të
krijojë një kulturë të re, të shpikë një histori
të re.*

*Para se të kalojë shumë kohë kombi do të
harrojë se çfarë është dhe çfarë qe.*